**Vërejtje për përdorimin:** Tek rrushi për verë të ndërpriten trajtimet 40 ditë para vjeljes, për të mos penguar fermentimin e mushtit.

**Fitotoksiciteti:** Tek rrushi i tavolinës, para se të bëhet përzierje me preparate të tjera, të verifikohet selektiviteti në bimë të kufizuara. Spërkatjet me vajra minarale nuk duhet të kryhen pa kaluar 30 ditë nga trajtimi me FOLPET.

**Ndikimi në mjedis:** Mesatarisht helmues për gjitarët. Pak helmues për zogjtë. Pak helmues për bletët. Mesatarisht helmues për peshqit. Mesatarisht helmues për jovertebrorët ujorë. Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.

- Prova te shumta eksperimentale kane evidentuar selektivitetin e larte te FOLPET mbi popullatat e kepushave fitoseide predatore dhe blete. Per kete arsye perdorimi i FOLPET eshte i lejueshem ne programet e luftes se integruar.

**Karenca:** 7 ditë për domaten, 10 ditë për rrushin e tavolinës dhe luleshtrydhen, 21 ditë për kungulloret, 40 ditë për rrushin për verë, 120 dite per ullirin.

**Magazinimi:** Ruhet në vende të thata, në temperatura jo më të ulëta se –10° C dhe jo më të larta se 35° C

**KUJDES**

Dt. Prod.: stampuar ne qese

Periudha e ruajtjes: 3 vjet

## Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- **Në rast kontakti hiqni menjëherë rrobat e ndotura. Lani menjëherë pjesët e ndotura të trupit me ujë të bollshëm e sapun.**
- **Nëse bie në kontakt me sytë kërkoni ndihmë mjekësore.**
- **Nxireni të demtuarin në ajër të pastër. Nëse i demtuari ka humbur ndjenjat, shtrijeni dhe transportojeni në pozicion anësor.**
- **Në rast se është gëlltitur mos provokoni të vjella, bëni lavazh të stomakut.**
- **Në rast dëmtimi kërkoni ndihmë mjekësore në qendrën spitalore më të afërt dhe tregojini mjekut etiketën.**
- **Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi simptomatik.**

# FOLPAN 80 WDG

## ADAMA

**"Produkt për mbrojtjen e bimëve"**

**Lënda vepruese:** *Folpet 80 %*
**Formulimi:** *Granula të dispergueshme në ujë (WDG)*
**Nr. i regjistrimit:** *400, date 26.05.2011*

## FUNGICID ME VEPRIM KONTAKTI DHE EFEKT PARAMBROJTËS PËR KONTROLLIN E SHUMË SËMUNDJEVE KËRPUDHORE NË PEMËT FRUTORE, AGRUME, ULLINJ, PERIME, PATATE, LULESHTRYDHE.

MELDI Sh.p.k

Distributor:
**MELDI Sh.p.k.**
**Tiranë - Shqipëri**

Aplikant: **ADAMA Agriculture BV**
Prodhuesi: **ADAMA Makhteshim Ltd, Israel**

## Masat parambrojtëse:

- **Mbajeni në vende të sigurta dhe të pa arritëshme nga fëmijët.**
- **Ruajeni në vende të thata dhe të freskëta, larg ushqimevëe dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.**
- **Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lëkurës me preparatin**
- **Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë pregatitjes së solucionit spërkatës dhe gjatë spërkatjes.**
- **Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan.**
- **Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze.**
- **Në përfundim të punës lani paisjet mbrojtëse, mjetet spërkatëse.**
- **Pas perfundimit të punës lani duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit.**
- **Bëni shkatërrimin e ambalazhit sipas rregullave në fuqi.**

**Përdorimi:**

**- *Në hardhi,*** efikasiteti i FOLPAN ne mbrojtjen e veshulit nga Vrugu dhe Kalbezimi gri eshte unik.

Për shkak te mekanizmit specifik te veprimit, duke nderhyre ne frymemarjen qelizore pengon mbirjen e sporeve dhe zhvillimin e micelit te kerpudhes duke ulur ne menyre te ndjeshme krijimin e cepave rezistente te kerpudhave dhe rit efikasitetin e produktit. Shume efektiv per luftimin e vrugut *(Plasmopara viticola),* kalbëzimit gri (*Botrytis cinerea),* kalbëzimit të zi (*Guignardia bidëelli*), kancerit të hardhisë *(Phomosis spp).,* njollosjes së kuqe të gjetheve (*Pseudopeziza tracheiphila).* Përdorimi në fillim të lulëzimit ndikon shumë mirë për lidhjen e frutave (pllenimin) si dhe për një zhvillim të mirë vegjetativ. ***Ka një veprim shumë të mirë dhe agresiv kundër eskoriozës (Phomopsis viticola), krahasuar me të gjithe produktet e tjera, prandaj këshillohet përdorimi që ne fazat e para të vegjetacionit.***

***Në pemët frutore:*** kundër kromave (*Venturia inequalis & V.pirina*), alternaries (*Alternaria sp*), kalbëzimit të zi (*Glomerella cingulata*), gjethepërdredheses (*Taphrina deformans*), antraknozave (*Gleosporium fructigenum*), ndryshkut (*Tranzshelia discolor*), Njollosja e kuqe e gjetheve te berthamoreve (Polystigma ocharaceum), Kalbezimi kafe (Monilia fructicola).

***- Në perime: domate, kungullore, bostanore, patate, qepë dhe luleshtrydhe,*** për kontrollin e vrugut te domates ( si dhe të sëmundjeve të tjera si: kalbëzimet *(Botrytis spp.)*,(Pythium sp), Vecanerisht shume efektiv per parandalimin e kalbezimit te hershem dhe te vonshem ne domate (kercell dhe koker),antraknozat, *Cladospora, Colletotrichum, Septoria spp.,* alternaria *(Alternaria spp.)* etj.

***- Në ulli,*** për kontrollin e Syrit te palloit, (*Spilocaea oleagina).* Kryhen deri 4 trajtime ne sezon me interval 7-10 dite.

- ***Ne agrume*** kunder melanoses (Mycosphaerella citri) dhe Elsinoe faëcetti.

Përdoret në të gjithë kulturat me 150-200 gr preparat/100 lit ujë.

**1 KG**